

VENDIM
Nr. 147, datë 8.7.2025

**MBI KËRKESËN E “TAP AG” PËR PËRJASHTIMIN NGA ZBATIMI I
STANDARDIT ISO 27001**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 13, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturës së informacionit kritik dhe të rëndësishëm”, të ndryshuar me VKM-në nr. 761, datë 12.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”; të “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 126, datë 30.7.2020; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1940/1 prot., datë 3.7.2025, të Sektorit të Sigurisë Kibernetike dhe IT-së “Mbi kërkesën e ‘TAP AG’ për moszbatimin e standardit ISO 27001”,

konstatoi se:

- Shoqëria “TAP AG”, me shkresën e saj nr. 1940 prot., datë 25.6.2025, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për moszbatimin e detyrimit për t’u certifikuar sipas standardit ISO/IEC 27001, të përcaktuar në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë”.

- “TAP AG” ka argumentuar se, për shkak të karakterit ndërkufitar të veprimtarisë së saj dhe klasifikimit të saj si subjekt thelbësor në kuadër të direktivës (BE) 2022/2555 (NIS2), ajo i nënshtrohet mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente të Greqisë dhe Italisë, dhe zbaton të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo direktivë, në përputhje edhe me garancitë ligjore të parashikuara në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, ratifikuar me ligjin nr. 102/2013.

- Duke marrë në konsideratë përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë kibernetike të “TAP AG” me kërkesat e direktivës NIS2, dhe në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, vlerësojmë të pranojmë kërkesën e shoqërisë “TAP AG”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së “TAP AG” për përjashtimin nga zbatimi i standardit ISO/IEC 27001, sipas “Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturës Kritike në Sektorin e Energjisë”.

2. “TAP AG” të klasifikohet si subjekt në kuadër të zbatimit të direktivës NIS2, për sa i përket veprimtarisë në Shqipëri.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “TAP AG” dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti